



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 101 Datë 19.07.2012

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PER VENDOSJEN E GJOBAVE
DHE KUSHTEVE TE LEHTËSIMIT PREJ TYRE**

Ne mbeshtetje te nenit 8 pika 2, 9 dhe 64, pika 3, te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorine e Energjise Eletrike”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10279, date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative”, neneve 25 dhe 26 te “Rregullave te praktikes dhe procedurave te ERE”, te miratuara me vendimin nr. 21, date 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Komisionereve te ERE-se në mbledhjen e tij të datës __.07.2012, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës,

Vendosi:

1. Të miratoje “Rregulloren per vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtesimit prej tyre”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit per njoftimin e paleve te interesuara per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI